



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

**RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHËM NË KUADËR TË AKREDITIMIT  
TË PJESHËM INSTITUCIONAL**

**Universiteti “Barleti”**

Grupi *ad hoc* i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof Asoc. Kita Sallabanda Diaz

2. Prof. Anila Hoda

**Shtator 2024**

**Raport i Grupit *ad hoc* të Vlerësimit të Jashtëm (GVJ)**  
**për verifikimin e standardeve për akreditimin e pjesshëm institucional të**  
**Universitetit “Barleti” (UB)**

Draft raporti i vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të pjesshëm institucional, u dërgua në institucion me anë të sistemit AMS në datë 25 Shtator. IAL përmes sistemit AMS më datë 01 Tetor, ka kthyer përgjigje mbi Draft raportin, duke u shprehur “*në tërësi dakord me përmbajtjen dhe vlerësimin e ekspertëve*”. Si rrjedhojë draft raporti merr formën e tij finale në raport të vlerësimit të jashtëm.

**I. Plani i takimeve të GVJ**

Në kuadër të procesit të akreditimit të pjesshëm institucional të Universitetit Barleti, është realizuar një plan takimesh për grupin *ad hoc*, i cili përbëhet nga Prof. Kita Sallabanda Diaz (anëtar BA) dhe Prof. Anila Hoda. Vizita e grupit *ad hoc* u zhvillua më datë 22 maj 2024 dhe përfshiu një sërë takimesh me përfaqësues të ndryshëm të universitetit. Më poshtë paraqitet agjenda e detajuar e kësaj vizite.

**Takimi i Grupit *ad hoc*.** Në këtë takim të parë, Grupi *ad hoc* së bashku me Koordinatorin Teknik të ASCAL Z. Erjon Xhako dhe Koordinatorin Institucional biseduan për agjendën e ditës dhe bënë një rishikim të përgjithshëm të qëllimeve dhe objektivave të vizitës.

**Takim me Rektorin e institucionit.** Rektori i Universitetit Barleti Prof. Suzana Guxholli u takua me Grupin *ad hoc* për të diskutuar mbi qëllimin e vizitës, si dhe për të dhënë një panoramë të përgjithshme të veprimtarive të universitetit.

**Takim me Dekanin e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.** Në këtë takim, Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore prezantoi strukturën dhe funksionimin e fakultetit, programet e studimit dhe sfidat e mundshme që ata përballen.

**Takim me Drejtuesit e Departamenteve të Fakultetit të Shkencave Mjekësore.** Drejtuesit e tre Departamenteve diskutuan mbi punën e tyre specifike brenda fakultetit, përfshirë kërkimet shkencore, mësimdhënien dhe projektet e bashkëpunimit, sfidat.

**Takim me Studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore.** Ky takim përfshiu një grup studentësh nga të gjitha ciklet e studimit të cilët ndanë përvojat e tyre akademike dhe sfidat që ata përballen në universitet.

**Takim me personelin akademik të Fakultetit të Shkencave Mjekësore.** Në këtë takim morën pjesë personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme i Fakultetit, për të diskutuar mbi metodologjitë e mësimdhënies, kërkimet dhe projektet kërkimore.



**Takim me përfaqësues të zyrave mbështetëse të institucionit.** Përfaqësues të Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Zyrës së Burimeve Njerëzore, Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, Sekretarisë mësimore dhe Bibliotekës diskutuan mbi mbështetjen që ata ofrojnë për studentët dhe stafin akademik.

**Vëzhgimi i mjediseve (auditorë, laboratorë, vizitë në bibliotekë, etj).** Grupi *ad hoc* bëri një vizitë të mjediseve të universitetit, duke përfshirë auditorët, laboratorët dhe bibliotekën, për të vlerësuar kushtet dhe pajisjet e ofruara. Gjatë vizitës së tyre, grupi *ad hoc* vëzhgoi një seancë laboratorike ku studentët po zhvillonin punë individuale për modelimin e dhëmbëve, nën mbikëqyrjen e pedagogut të lëndës. Grupi pati mundësinë të vëzhgojë nga afër procesin e punës praktike të studentëve dhe të diskutojë me ta rreth përvojave dhe metodave të përdorura në laborator.

**Takimi përmbyllës me Rektorin.** Në fund të vizitës, Grupi *ad hoc* pati një takim përmbyllës me Rektorin për të dhënë një përmbledhje të vlerësimeve dhe për të diskutuar hapat e ardhshëm në procesin e akreditimit.

## **II. Dokumentet në dispozicion të grupit “ad-hoc”**

Institucion ka përgatitur dhe vënë në dispozicion të grupit *ad hoc*, përmes sistemit AMS një gamë të gjerë dokumentesh (shih listen e evidencave në fund të raportit). Grupi *ad hoc* u njoh paraprakisht me listen e evidencave, para vizitës në institucion. Këto dokumenta përfshijnë urdhëra, strategji zhvillimi, rregullore, raporte vjetore, manuale, plane pune, dhe dokumente të tjera të rëndësishme që mbështesin funksionimin dhe menaxhimin e Universitetit "Barleti" dhe Fakultetit të Shkencave Mjekësore (FSHM). Këto dokumente mbulojnë aspekte të ndryshme të funksionimit të universitetit, nga strukturat organizative dhe strategjitë e zhvillimit deri te rregulloret specifike dhe raportet e performancës. Lista e evidencave mund të ndahet në disa grupime si më poshtë:

### **1. Dokumente Strategjike dhe Legjislative:**

- **Urdhëra të Rektorit dhe MAS:** Dokumentet si urdhërat për ngritjen dhe riorganizimin e fakultetit dhe programeve të ndryshme të studimit janë të rëndësishme për krijimin dhe funksionimin e ligjshëm të institucioneve akademike. Këto urdhëra vendosin kornizat ligjore dhe administrative të nevojshme për veprimtarinë e tyre.
- **Strategjitë e Zhvillimit Institucional:** Strategjia e zhvillimit 2020-2030 dhe strategjia e ndërkombëtarizimit janë dokumenta të rëndësishëm për planifikimin afatgjatë të universitetit dhe për pozicionimin e tij në arenën ndërkombëtare.

### **2. Rregullore dhe Manuale:**

- **Rregulloret e Universitetit dhe Fakultetit:** Këto dokumente përfshijnë rregulloret e ndryshme për funksionimin e fakulteteve, departamenteve, dhe



njësive të ndryshme. Ato përcaktojnë procedurat e brendshme dhe standardet që duhet të ndjekin stafi dhe studentët.

- **Manualet e Cilësisë dhe Administrimit:** Manualet e cilësisë dhe manualet e administrimit të burimeve njerëzore dhe të tjera ofrojnë udhëzime të detajuara për ruajtjen e standardeve të larta në universitet.

### 3. Raporte dhe Plane Pune:

- **Raportet Vjetore:** Raportet vjetore të universitetit dhe të fakultetit japin një pasqyrë të arritjeve, sfidave dhe performancës së institucionit, si dhe stafit gjatë një periudhe të caktuar. Këto raporte janë të rëndësishme për transparencën dhe llogaridhënien.
- **Planet e Punës:** Planet e punës për njësitë e zhvillimit kurrikulave dhe cilësisë, dhe për dekanatin e studentëve, janë të rëndësishme për planifikimin dhe monitorimin e aktiviteteve dhe iniciativave të ndryshme.

### 4. Dokumente për Infrastrukturën dhe Burimet Financiare:

- **Dokumentet e Infrastrukturës:** Dokumentet mbi planimetrinë, certifikatat e pronësisë, dhe raportet mbi standardet e infrastrukturës janë të rëndësishme për të siguruar që mjediset fizike të universitetit përmbushin standardet e nevojshme për një mësimdhënie dhe mësimnxënie efektive.
- **Burimet Financiare:** Plan biznesi dhe raportet e auditimit janë kritike për menaxhimin financiar të universitetit dhe për garancinë që fondet përdoren në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme.

Grupi *ad hoc*, gjykon se lista e evidencave përmban dokumente të rëndësiahmë për strukturën, funksionimin dhe zhvillimin e Universitetit "Barleti". Këto dokumente ofrojnë një bazë të fortë për menaxhimin efektiv të universitetit dhe për sigurimin e cilësisë në të gjitha aspektet e funksionimit të tij.

### III. Gjendja e infrastrukturës së UB

Universiteti Barleti (UB) është në një zhvillim të vazhdueshëm dhe progresiv të infrastrukturës së tij gjatë 19 viteve të fundit. UB ka dy kampuse kryesore:

- **Kampusi 1:** Ky kampus është në funksion që nga themelimi i universitetit dhe është rikonstruktuar për herë të fundit në vitin 2019 [Ev. 45].
- **Kampusi 2:** Kampusi i dytë është ngritur në vitin 2010, dhe për të mbështetur rritjen strategjike, UB filloi ndërtimin e një godine të re bashkëkohore në vitin 2019. Fakulteti i Shkencave Mjekësore (FSHM) është vendosur në këtë kampus, duke shfrytëzuar zyrat dhe auditorët në godinën ekzistuese dhe laboratorët në katin -1 të godinës së re, ndërsa auditorët dhe zyrat ndodhen në katet 3 dhe 4 [Ev. 45.1, Ev. 45.3].



UB zotëron një infrastrukturë të përshtatshme për veprimtarinë akademike-shkencore. Kontrollat nga autoritetet shtetërore konfirmojnë se ndërtimet janë kryer në përputhje me kushtet teknike, ligjore, materiale cilësore dhe normat higjeno-sanitare. Përveç kësaj, UB kryen kontrole teknike për mbrojtjen kundra zjarrit dhe ka aparate të specializuara për mbrojtjen nga zjarri në çdo mjedis, si dhe sisteme kundër shkarkesave atmosferike [Ev. 45.4].

Në Raportin e Auditimit Financiar tregohet se të ardhurat nga tarifat e studentëve janë përdorur për rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe shërbimeve për studentët, përfshirë investimet në infrastrukturë dhe pajisje teknologjike dhe IT [Ev. 46, Ev. 46.1, Ev. 46.2].

UB ka përmirësuar dhe zgjeruar vazhdimisht infrastrukturën, teknologjinë dhe platformat e informacionit për të mbështetur studentët dhe mësimdhënien. Sallat janë të pajisura me infrastrukturën e nevojshme imobiliare dhe me mjetet e nevojshme teknologjike si kompjutera, videoprojektorë, dhe rrjet wireless [Ev. 45, vizita në institucion].

Institucioni siguron pajisje laboratorike, infrastrukturë dhe shërbime për mbështetjen e programeve të studimit. Laboratorët janë të pajisur me aparatura, mjete didaktike bashkëkohore, reagentë dhe materiale konsumi të mjaftueshme për orët laboratorike [Ev. 45, vizita në institucion].

Biblioteka dhe infrastruktura e saj sigurojnë akses në literaturë bashkëkohore. Biblioteka e UB është shpërndarë në hapësira të ndryshme të universitetit për të ofruar libra pranë studentëve. Fondi i titujve dedikuar FSHM-së është 146 tituj, dhe menaxhimi bëhet përmes një platforme online që ofron akses në bibliotekat ndërkombëtare dhe shërbime të tjera digjitale [Ev. 64, Ev. 49, pika II.3]. Biblioteka e UB ofron akses në literaturë dhe burime shkencore përmes platformës online, duke përfshirë bibliotekat ndërkombëtare dhe mjetet për kontrollin e cilësisë [Ev. 64; Ev. 49, pika II.3]. Kjo ndihmon në përmirësimin e kërkimeve dhe studimeve akademike.

UB ofron një infrastrukturë moderne për studentët, duke përfshirë ambiente sportive, laboratorë, salla informatike, salla leximi, ambiente co-working, kafeteri dhe shërbime mbështetëse logjistike [Ev. 45, vizita në institucion]. FSHM disponon laboratore të pajisura me teknologji moderne për mbështetje të programeve të studimit si dhe për realizimin e kërkimeve shkencore. Klinika ambulatorie “Origin Clinic” do të hapet në vitin 2024 për të përmirësuar përgatitjen praktike të studentëve [Ev. 45]. Laboratorët janë të pajisur me aparatura dhe materiale të mjaftueshme për mësim dhe kërkime shkencore [Ev. 45]. UniBa siguron cilësinë e mësimdhënies, si dhe formimin praktik përmes pajisjeve bashkëkohore

Infrastruktura e UB është e zhvilluar dhe moderne, duke mbështetur plotësisht veprimtarinë akademike dhe kërkimore. Investimet e vazhdueshme në infrastrukturë, teknologji dhe shërbime tregojnë përkushtimin e universitetit ndaj cilësisë së mësimdhënies dhe mirëqenies së studentëve. Zhvillimi strategjik i kampuseve dhe krijimi i hapësirave moderne për laboratorët dhe auditorët për Fakultetin e Shkencave Mjekësore reflekton një planifikim të mirë dhe një orientim drejt standardeve të larta ndërkombëtare.

Përdorimi efektiv i të ardhurave nga tarifat e studentëve për përmirësimin e infrastrukturës dhe shërbimeve teknologjike tregon një angazhim për të ofruar një mjedis të përshtatshëm për studim



dhe kërkim. Gjithashtu, monitorimi i vazhdueshëm dhe përmirësimi i infrastrukturës fizike siguron që UB të mbetet një institucion i sigurt dhe i besueshëm për studentët dhe stafin akademik.

#### IV. Organizimi dhe autoritetet akademike të UB

UB dhe strukturat e tij funksionojnë në përputhje me statutin e institucionit, i cili është dokumenti themelor që përcakton organizimin dhe funksionimin e tij. Ky statut është miratuar nga Ministria e Arsimit, Sportit (MAS) me urdhër nr. 360 datë 23.12.2020. Statuti pasqyron detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për arsimin e lartë dhe reflekton misionin dhe vizionin e UB, të shprehur edhe në planin e zhvillimit strategjik të institucionit [Ev. 5, Ev. 6, Ev. 6.1, Ev. 4.1].

Statuti rregullon marrëdhëniet mes Bordit të Besuarve, Bordit të Administrimit dhe organeve dhe autoriteteve drejtuese të UB. Autonomia e palëve dhe ndërvarësia mes tyre janë të qarta përmes organizimit dhe përgjegjësive të secilës strukturë, siç përshkruhet në statut dhe në rregulloren e institucionit [Ev. 6 nenet 12-18, Ev. 7].

- **Rektori** është autoriteti më i lartë akademik i UB, si dhe përfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare. **Administratori** dhe i deleguari i tij është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për drejtimin dhe mirë funksionimin financiar të UB. Autoritetet të tjera drejtuese akademike janë Zëvendës Rektorët, Dekanët, Drejtuesit e Departamenteve dhe Drejtuesit e Qendrave Kërkimore Shkencore [Ev. 6, Ev. 7].
- **Senati Akademik** është organi drejtues kolegjal më i lartë akademik i UB, përgjegjës për përmbushjen e misionit të tij. Ai vendos për çështjet më të rëndësishme të procesit mësimor dhe kërkimor dhe ka kompetenca të tjera të përcaktuara në statut dhe aktet e tjera normative të institucionit [Ev. 6, neni 20].
- **Asambleja e Personelit Akademik** dhe **Komisionet e Përhershme**, si Këshilli i Etikës dhe Mundësive të Barabarta, Komisioni i Vlerësimit të Performancës dhe Komisioni i Sigurimit të Standardeve të Cilësisë [Ev. 6, nenet 22-23, 26-28].
- **Rektorati** është një organ kolegjal drejtuar nga Rektori dhe përbëhet nga Rektori, Zëvendës Rektorët, Administratori i institucionit dhe drejtuesit e njësive kryesore. Rektorati, bazuar në propozimet e Senatit për kërkesat buxhetore për vitin pasardhës dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, i propozon Bordit të Administrimit buxhetin i cili më pas miratohet nga Bordi i Administrimit [Ev. 6 neni 24].
- Në nivel njësie kryesore, organi më i lartë kolegjal është **Dekanati** i cili drejtohet nga Dekani.

Në takimet e Rektoratit, të Senatit dhe organeve të tjera drejtuese të UB, merren vendime që synojnë nxitjen e stafit akademik drejt kualifikimeve të mëtejshme [Ev. 11, Ev. 12]. Grupi *ad hoc* në takimet që zhvilloi me stafin akademik të UB u informua për mbështetjen që ata marrin nga institucioni, veçanërisht për publikimet dhe pjesëmarrjen në konferenca.

Organizimi i UB është i qartë dhe efektiv, duke siguruar një ndarje të mirë të përgjegjësive dhe kompetencave mes organeve dhe autoriteteve të ndryshme. Ky organizim i strukturuar garanton



që universiteti të funksionojë në përputhje me statutin dhe legjislacionin përkatës, duke mbështetur efikasitetin në menaxhim dhe qeverisje.

Ndarja e përgjegjësiave mes Bordit të Besuarve, Bordit të Administrimit, Senatit Akademik dhe organeve të tjera akademike siguron një ekuilibër të mirë mes autonomisë dhe ndërvlerësive së palëve. Kjo ndihmon në marrjen e vendimeve të drejta dhe të balancuara, si dhe informimin e stafit me këto vendime, duke përmirësuar funksionimin e përgjithshëm të universitetit.

Vendimet që nxisin kualifikimet e mëtejshme të stafit akademik tregojnë një përkushtim ndaj zhvillimit profesional të personelit, gjë që është thelbësore për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Ky përkushtim për kualifikimet e stafit rrit kapacitetet akademike dhe kërkimore të universitetit, duke e pozicionuar atë më mirë në tregun e arsimit të lartë.

Grupi *ad hoc* konkludon se struktura organizative dhe autoritetet akademike të UB janë të konceptuara dhe ngritura për të siguruar një menaxhim efikas dhe një funksionim të qëndrueshëm të institucionit. Përkushtimi ndaj kualifikimeve të stafit akademik dhe organizimi i qartë i përgjegjësiave janë elemente kyçe që kontribuojnë në përmbushjen e misionit dhe vizionit të universitetit.

## **V. Krijimi i njësive kryesore në UB**

Me urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit, Nr. 117, datë 09.03.2022 është miratuar hapja e Fakultetit të Shkencave Mjekësore, si edhe me urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 78, datë 09.02.2023 është miratuar ndryshimi i statutit dhe organigramës së institucionit, në përputhje me vendimin e Senatit Akademik Nr. 24, datë 17.10.2022.

### **V.1 Fakulteti i Shkencave Mjekësore**

#### **V.1.1. Departamentet dhe programet e studimit**

Njësia kryesore e krijuar përbëhet nga tre njësi bazë:

- Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe të Shëndetit
- Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike
- Departamenti i Formimit të Përgjithshëm dhe Zhvillimit Profesional

UB ofron programe studimi që përputhen me kërkesat e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, legjislacionin shqiptar, si dhe rregulloret e brendshme [Ev. 6, neni 1/3, neni 9]. Fakulteti i Shkencave Mjekësore (FSHM) ofron programe në total 6 programe studimi të cilët janë: Bachelor në “Infermieri”; Bachelor në “Fizioterapi”; Master Profesional në “Infermieri në Familje dhe Komunitet”; Master i Shkencave në “Menaxhim, Financim dhe Politika Shëndetësore”; Program studimi i integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Stomatologji” dhe Program studimi i integruar i ciklit të dytë Master i Shkencave në “Farmaci”. Të gjitha programet zhvillohen në gjuhën shqipe dhe janë të harmonizuara për të ndihmuar studentët të fitojnë kompetenca formuese dhe profesionale [Ev. 14, neni 5/2]. UB përmbush nevojat e tregut



dhe strategjinë e zhvillimit institucional, duke siguruar qartësi dhe përshtatshmëri me legjislacionin.

FSHM ofron programe në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015 për Arsimin e Lartë, përfshirë "Bachelor" dhe "Master" [Ev. 8]. Strukturat e programeve janë të qarta dhe lehtësojnë kalimin nga një cikël në tjetrin [Ev. 8]. Publikimi në website rrit transparencën dhe qasjen e informacionit për studentët potencialë [Ev. 8]. Programet janë krijuar për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies në përputhje me politikën kombëtare dhe ndërkombëtare [Ev. 16]. Ato ofrojnë arsimim të vazhdueshëm dhe janë të lidhura me projekte kërkimore [Ev. 18]. Programet përshtaten me nevojat e tregut të punës për të siguruar relevancën e tyre [Ev. 21]. UB angazhohet të mbajë përditësimin e programeve dhe të kontribuojë në kërkimin shkencor.

Programet e FSHM ofrojnë një kombinim të njohurive teorike dhe praktike, duke përfshirë praktikën në institucione shëndetësore si spitale dhe qendra shëndetësore [Ev. 10.1, Ev. 10.2]. Klinikat ambulatorë si "Origin Clinic" do të hapen në vitin 2024 për të mbështetur përgatitjen praktike [Ev. 30, takim me stafin, takim me studentët]. Praktikën ndihmojnë studentët të përgatiten për sfidat profesionale dhe të aplikojnë njohuritë në situata reale.

Programet e studimit kanë objektiva të qarta dhe përputhen me nivelin dhe profilin e kualifikimit [Ev. 23]. Syllabuset dhe rezultatet e të nxënies janë të disponueshme për studentët përmes intranetit dhe prezantohen nga pedagogu në javën e parë të mësimit [Ev. 27]. UB siguron qasje të lehtë në përmbajtjen e programeve për të ndihmuar studentët në orientimin dhe përgatitjen për tregun e punës.

Programet e studimit realizohen sipas kapaciteteve fizike dhe njerëzore të UB, duke respektuar kërkesat ligjore [Ev. 33, Ev. 35, Ev. 37]. Ngarkesa mësimore caktohet sipas kritereve dhe numri i studentëve është në përputhje me kapacitetet e infrastrukturës akademike dhe laboratorëve

Programet e ciklit të parë "Bachelor" ofrojnë njohuri bazë dhe diploma përfundimtare [Ev. 6, neni 46; Ev. 7 neni 97]. Programet e ciklit të dytë ofrojnë studime të avancuara dhe diploma përkatëse [Ev. 6, neni 47; Ev. 7 neni 97]. UniBa siguron një strukturë të qartë dhe koherente për të ndihmuar studentët të avancojnë në karrierën e tyre.

UB promovon formimin e vazhdueshëm në përputhje me Strategjinë e Zhvillimit Institucional [Ev. 6 neni 7; Ev. 5]. Ofron programe të formimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunon me qendra trajnimi për të garantuar që programet të jenë të përshtatura për kërkesat e tregut [Ev. 7 neni 61; Ev. 51, Ev. 56]. Çertifikatat e lëshuara pas trajnimeve tregojnë një sistem të strukturuar të formimit.

Monitorimi i programeve bëhet përmes formularëve të vlerësimit nga studentët dhe përditësohen në përputhje me ndryshimet në planet mësimore dhe literaturën bashkëkohore [Ev. 32, Ev. 34, Ev. 35]. Ky monitorim siguron përditësimin e programeve dhe përputhshmërinë me kërkesat e studentëve dhe tregut. Programet e studimeve në UniBa janë subjekt i përmirësimit të vazhdueshëm për të rritur cilësinë. Departamentet dhe NJZHKC bazuar në të dhënat e mbledhura nga vlerësimi i studentëve, realizojnë analiza dhe krijojnë raporte për përmirësim të mëtejshëm [Ev. 33]. Vendimet për përmirësimin bazohen në analizën e sondazheve dhe vlerësimeve [Ev.





25]. Programet mund të përmirësohen deri në 20% pas vlerësimit të jashtëm, për të ruajtur standardet akademike të larta. Procesi i përmirësimit ndihmon në mbajtjen e programeve të përditësuara dhe të përshtatura me nevojat e studentëve dhe tregut të punës.

## V.2. Përbërja dhe kualifikimi i personelit akademik sipas departamenteve

Përbërja dhe kualifikimi i stafit akademik në Fakultetin e Shkencave Mjekësore të UB është në përputhje me standardet e kërkuara për të siguruar cilësinë dhe efikasitetin e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Politikat e hapura për rekrutimin dhe vlerësimin e performancës sigurojnë angazhimin e stafit të kualifikuar dhe të motivuar, ndërsa mbështetje për zhvillimin e mëtejshëm dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies janë të integruara në mënyrë efektive. Personeli akademik në përbërje të Fakultetit të Shkencave Mjekësore për vitin akademik 2023—024 është si vijon:

### 1) Departamenti i Shkencave Mjekësore dhe të Shëndetit

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**, prej të cilëve:

- 2 Prof. Dr.
- 2 Dr.
- 3 Msc.

Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **5 pedagogë**, prej të cilëve:

- 2 Prof.
- 1 Prof As.
- 1 Dr.
- 1 Msc.

### 2) Departamenti i Shkencave Mjekësore Teknike

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 1 Prof.
- 2 Dr./PhD.
- 4 Msc.

Personeli akademik me kohë të pjesshme paraqitur në raport (PAK), është i përbërë nga **8 pedagogë**:

- 3 Dr.
- 5 Msc



### 3) Departamenti i Formimit të Përgjithshëm dhe Zhvillimit Profesional

Personeli akademik me kohë të plotë paraqitur në raport (PAE), është i përbërë nga **7 pedagogë**:

- 1 Prof.
- 1 Prof As.
- 1 Dr.
- 4 Msc.

Nuk ka personel akademik me kohë të pjesshme të paraqitur në raport (PAK).

Fakulteti i Shkencave Mjekësore në Universitetin "Barleti" ndjek një politikë të hapur për rekrutimin dhe punësimin e stafit akademik në përputhje me rregulloren e universitetit dhe Manualin e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore. Kjo politikë është e projektuar për të siguruar që procesi i rekrutimit të jetë transparent dhe i bazuar në kritere të qarta [Ev. 7, neni 55; Ev. 39].

UB ka një politikë të qartë të vlerësimit dhe zhvillimit të aftësive. Vlerësimi i performancës bëhet dy herë në vit, në përfundim të semestrit akademik [Ev. 36]. Vlerësimi është shumë dimensional dhe përfshin angazhimin në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe detyra administrative [Ev. 41]. Politika e UniBa përfshin trajnime dhe zhvillime të mëtejshme për stafin akademik përmes pjesëmarrjes në konferenca dhe trajnime brenda dhe jashtë vendit [Ev. 42]. Komisioni i Vlerësimit të Performancës shqyrton dokumentacionin lidhur me vlerësimin e performancës dhe kontribuon në përcaktimin e kualifikimeve dhe angazhimeve të stafit akademik [Ev. 6, neni 27].

Për të siguruar një qëndrueshmëri të personelit akademik, UB ndjek një politikë të mirëpërcaktuar të kontratave. Stafi akademik është i angazhuar përmes kontratave përkatëse sipas Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kodit të Punës [Ev. 55]. UB ka implementuar masa për të siguruar qëndrueshmërinë e stafit akademik, duke përfshirë mundësi për mobilitete dhe pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare, kryesisht Erasmus [Ev. 44; Ev. 14, takimi me stafin akademik]. Pedagogët e FSHM përfitojnë trajnime dhe zhvillim profesional për metodologji dhe metoda të mësimdhënies, përfshirë vizita dhe shkëmbime me universitetet ndërkombëtare [Ev. 44, takimi me stafin akademik]. Këto ndihmojnë dhe kanë efekt pozitiv në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies.

Aktivitetet kërkimore në UB menaxhohen nga Zv. Rektori për Kërkimin e Aplikuar dhe Inovacionin dhe koordinohen nga qendrat kërkimore dhe zyra e menaxhimit të projekteve [Ev. 7, neni 27]. Personeli akademik angazhohet në kërkimin shkencor dhe vlerësohet për performancën e tij në projekte dhe aktivitete kërkimore. Kërkimi është i lidhur ngushtë me eksperiencën akademike dhe kontribuon në përditësimin e dijes [Ev. 36; Ev. 42, takimi me stafin akademik]. Stafi akademik është i angazhuar në aktivitete kërkimore dhe akademike që kontribuojnë në avancimin e dijes dhe përmirësimin e metodave të mësimdhënies, ndërsa politikat e mbështetjes për kualifikimin dhe promovimin e stafit janë të strukturuar për të siguruar një qëndrueshmëri të gjatë dhe zhvillim të vazhdueshëm profesional.



### **Përfundimet e Grupit *ad hoc* të vlerësimit të jashtëm:**

1. Organizimi i qartë dhe efektiv i strukturave të Universitetit Barleti garanton funksionim të qëndrueshëm dhe efikas të institucionit.
2. Përkushtimi ndaj kualifikimit dhe zhvillimit të stafit akademik përmirëson cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
3. Investimet në infrastrukturë dhe teknologji tregojnë një angazhim të fortë për të ofruar një mjedis të përshtatshëm për studim dhe kërkim.
4. Programet e studimit janë të përditësuara dhe të përshtatura me nevojat e studentëve dhe tregut të punës, duke siguruar përputhshmëri me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.
5. Universiteti ofron një gamë të gjerë shërbimesh mbështetëse për studentët, përfshirë karrierën, burimet njerëzore, dhe bibliotekën, të cilat janë të aksesueshme dhe të organizuara mirë.

### **Rekomandime:**

- Të vazhdohet me investimet në infrastrukturë dhe teknologji për të mbajtur hapin me zhvillimet bashkëkohore.
- Të rritet bashkëpunimi ndërkombëtar dhe pjesëmarrja në projekte kërkimore për të avancuar më tej cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit.
- Të vijohet dhe sigurohet përditësimi i vazhdueshëm i programeve të studimit për të reflektuar ndryshimet në tregun e punës dhe nevojat e studentëve.

### **Grupi *ad hoc* i Vlerësimit të Jashtëm**

**Prof. Asoc. Kita Sallabanda Diaz**



**Prof. Anila Hoda**



## Lista e evidencave mbështetëse të RVB-së

- Ev. 1. Urdhër Rektori për ngritjen e GVB-së
- Ev. 2. Dhenie leje për hapje të Institucionit
- Ev. 2.1 Urdhër për Riorganizimin Institucional 2019
- Ev. 2.2 Urdhër për Riorganizim për ndryshimin e statusit 2020
- Ev. 3. Urdhër hapje për Fakultetin e Shkencave Mjekësore
- Ev. 3.1. Urdhër hapje për programin e integruar “Master i Shkencave” në “Farmaci”
- Ev. 3.2. Urdhër hapje për programin e integruar “Master i Shkencave” në “Stomatologji”
- Ev. 3.3. Urdhër hapje për programin e studimit “Bachelor” në “Infermieri”
- Ev. 3.4. Urdhër hapje për programin e studimit “Bachelor” në “Fizioterapi”
- Ev. 3.5. Urdhër hapje për programin e studimit “Master Profesional” në “Infermieri në Familje dhe Komunitet”
- Ev. 3.6. Urdhër hapje për programin e studimit “Master i Shkencave” në “Menaxhim, Financim dhe Politika Shëndetësore”
- Ev. 4. Organigrama e Universitetit “Barleti”
- Ev. 4.1. Dërgohet për zbatim urdhri nr. 78 Miratimi i një ndryshimi në Statutin e UniBa-s
- Ev. 5. Strategjia e zhvillimit Institucional 2020-2030
- Ev. 6. Statuti
- Ev. 6.1. Urdhër 360, datë 23.12.2020 Për miratimin e Statutit
- Ev. 7. Rregullore e Universitetit
- Ev. 8. Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekësore
- Ev. 9. Rregullore e Departamentit të Shkencave Mjekësore Teknike
- Ev. 10.1. Rregullore e programit të studimit “Bachelor” në “Infermieri”
- Ev. 10.2. Rregullore e programit të integruar të studimit “Master i Shkencave” në “Farmaci”
- Ev. 11. Lista e vendimeve të Senatit 2022-2024
- Ev.12. Lista e vendimeve të Rektoratit/Rektorit 2022-2024
- Ev. 13. Rregullore e Njësisë të Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë
- Ev. 14. Lista e projekteve ku është përfshirë stafi i FSHM
- Ev. 15.Strategjia e Ndërkombtarizimit
- Ev. 16. UniBa Intraneti
- Ev. 17. Email njoftues për mbledhje Senati Akademik
- Ev. 18. Lista e mbledhjeve të Bordit 2022-2024
- Ev. 19. Lista e mbledhjeve të Senatit 2022-2024
- Ev. 20. Lista e mbledhjeve të FSHM
- Ev. 21. Raporti vjetor UniBa v.a. 2022-2023
- Ev. 22. Raport vjetor FSHM v.a.2022-2023
- Ev. 23. Rregullore e Komisionit të Sigurimit të Standarteve të Cilësisë
- Ev. 24. Manuali i cilesise
- Ev. 25. Manuali i hartimit, riorganizimit, mbylljes dhe vlerësimit të programeve të studimit
- Ev. 26. Udhëzues për metodat e mësimdhënies
- Ev. 27. Plani punës Njësisë së Zhvillimit Kurrikular dhe Cilësisë
- Ev. 28. Rregullore e funksionimit të zyrave në shërbim të studentëve pranë UniBa
- EV. 29. Plani Strategjik Alumni dhe Karriera 2020 – 2025
- Ev. 30. Liste e marrëveshjeve të bashkepunimit në funksion të FSHM
- Ev. 30.1 Lista e marreveshjeve të bashkepunimit në rang institucional
- Ev. 31. Raport vjetor i Departamentit të Shkencave Mjekësore Teknike
- Ev. 32. Formular vlerësimi i studentëve për lëndën/pedagogun
- Ev. 33 Raporti i vlerësimit të studentëve per v.a. 2022-2023 - Sem. I
- Ev. 34. Formular për transparencë të vlerësimit të studentëve
- Ev. 35. Formular vlerësimi të mësimdhënies kolegë me kolegë
- Ev. 36. Format i raportimit të punës semestrale
- Ev. 37. Vendimi i senatit për përbërjen e KSSC



- Ev. 38. Raport për Vlerësimin e Cilësisë në UniBa
- Ev. 39. Manuali Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
- Ev. 40. Lista e stafit akademik të FSHM të kualifikuar jashtë Shqipërisë
- Ev. 41. Rregullore e Vlerësimit dhe Administrimit të Performancës
- Ev. 42. Raporti vjetor i kërkimit shkencor v.a. 2022- 2023 \_FSHM
- Ev. 43. Listë e konferencave, trajnime, leksione të hapura, ëorkshop \_FSHM (me hyperlinks)
- Ev. 44. Të dhëna mbi MoU, mobilitetin e stafit dhe studentëve në kuadër të programit Erasmus +
- Ev. 45. Relacion për infrastrukturën në funksion të FSHM
- Ev. 45.1. Planimetria (Shtojca 1 dhe Shtojca 2)
- Ev. 45.2. Çertifikata e Pronësisë
- Ev. 45.3. Raport mbi verifikimin e standardeve dhe normativave të infrastrukturës për hapjen e FSHM
- Ev. 45.4. Çertifikata mbrojtje nga zjarri dhe akte higjieno-sanitare
- Ev. 46. Burimet finaciare të UniBa
- Ev. 46.1. Plan biznesi
- Ev. 46.2 Raport Auditimi i brendshëm UNIBA 22-23
- Ev. 46.3. UMB\_FS\_2022\_ audit raport 2022
- Ev. 47. Rregullore e Protokollit dhe Arkivës
- Ev. 48. Rregullore për Funkcionimin e Sekretarisë Mësimore
- Ev. 49. Udhëzues për përdorimin e infrastrukturës së teknologjisë së informacionit UniBa
- Ev. 49.1 Manuali i përdorimit të portalit Studentor për administrim
- Ev. 50. Studim tregu per hapje program studimi
- Ev. 51. Listë me trajnime
- Ev. 52. Program i lëndës (syllabus model Bsc. dhe Msc.)
- Ev. 53.1. Rregullore e brendshme për transferimet e studentëve
- Ev. 53.2. Manual Rekrutim Aplikim Regjistrim Transferim i studentëve
- Ev. 54.1. Udhëzues për shpërndarjen e ngarkesës mësimore
- Ev. 54.2 Ngarkesa mësimore e stafit të FSHM v.a. 2022-2023, v.a. 2023-2024
- Ev. 55. Model kontratë punësimi për staf akademik të brendshëm
- Ev. 56. Rregullore e Departamentit të Formimit të Përgjithshëm dhe Zhvillimit Profesional
- Ev. 57. Staf akademik i FSHM v.a. 2022-2023, v.a. 2023-2024
- Ev. 58. Kalendari akademik v.a. 2023-2024
- Ev. 59. Plan mësimor model Bsc./Msc. Ev. 60. Paketa e praktikës profesionale
- Ev. 61. Listë e aktiviteteve të studentëve të FSHM
- Ev. 62. Model Teze
- Ev. 63. Model Diplome
- Ev. 64. Lista e titujve të librave në funksion të FSHM
- Ev. 64.1 Platforma e bibliotekës online
- Ev. 65. Veprimtaria Kërkimore, Monitorimi dhe Rezultatet
- Ev. 66. Kodi i Etikes
- Ev. 67. Kriteret e pranimit 2023-2024
- Ev. 67.1. Kriteret e pranimit 2024-2025
- Ev. 68.1 Politika të mbështetjes, përkrahjes për studentët dhe struktura organizative të tyre
- Ev. 68.2 Të dhëna për këshillat studentorë dhe përfaqësimin e tyre në organet drejtuese
- Ev. 68.3 Rregullore për organizimin e zgjedhjeve në Qeverine studnetore
- Ev. 68.4. Manuali i Klubeve Studentore 2022
- Ev. 68.5. Strategjia e klubeve studentore 2020-2025
- Ev. 68.6. Plani i punës Dekani i studentëve 2023-2024
- Ev. 69. Broshurë informuese
- Ev. 70. Kërkesë për pasurimin e bibliotekës.


